



Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryeza për Kapitullin 24: Fuqizimi i Përgjigjes së Shqipërisë ndaj Krimin Kibernetik dhe Mbrojtjes së Fëmijëve në Internet: Përmirësimi i Kuadrit Ligjor dhe i Kapaciteteve Institucionale

15 janar 2026

Xheko Imperial Hotel

09:00 - 11:00

Policia e Shtetit dhe **Lëvizja Europiane në Shqipëri** kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në takimin e radhës të **Grupit të Punës për Kapitullin 24 - Drejtësia, Liria Siguria**, të organizuar në kuadër të **Konventës Kombëtare për Integrimin Europian**, mbështetur nga **Bashkimi Evropian**. Takimi do të zhvillohet më **15 janar 2026**, nga ora **09:00** deri në orën **11:00**, në **Xheko Imperial Tirana**, salla: **Grand Imperial II**.

Grupi i Punës për Kapitullin 24 ofron një hapësirë për konsultim dhe dialog, duke mundësuar përfshirjen aktive të aktorëve jo-shtetërorë në procesin e negociatave me BE-në. Pjesëmarrësit përfshijnë përfaqësues nga shoqëria civile, academia, profesionistë të ligjit dhe palë të tjera të interesuara kryesore. Sesiioni synon jo vetëm të informojë rreth procesit legjislativ, por edhe të mundësojë shoqërinë civile dhe grupet e interesit të japin rekomandime, të ofrojnë sugjerime mbi kuadrin ligjor dhe politikën, dhe të monitorojnë në mënyrë aktive hartimin e politikave në të gjitha fazat.

Diskutimi do të përqendrohet te **krimi kibernetik në Shqipëri**, me vëmendje të veçantë ndaj **abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet**, si dhe në ndërtimin e kapaciteteve të **Policisë së Shtetit** sa i përket **hetimit të krimin kibernetik**, në përputhje me standardet dhe prioritetet e BE-së. Vlerësimet e fundit të Komisionit Europian nënvizojnë nevojën që Shqipëria të përshpejtojë përafrimin e kuadrit të saj ligjor me **acquis të BE-së**, veçanërisht në lidhje me kriminalizimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe forcimin e kapaciteteve hetimore në përputhje me prioritetet e **EMPACT** për periudhën **2022–2025**.

Takimi do të bëjë bashkë përfaqësues të **Policisë së Shtetit**, institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve dhe partnerëve ndërkombëtarë për të diskutuar sfidat aktuale në kuadrin ligjor dhe institucional të Shqipërisë mbi krimin kibernetik, nevojat praktike për ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin, dhe praktikën më të mira nga shtetet anëtare të BE-së. **Një ekspert slovak** nga Ministria e Brendshme e do të ndajë përvojën e një shteti anëtar dhe praktikën e mira në luftën kundër krimin kibernetik, sipas standardeve europiane.

Mirëpresm pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj në këtë tryezë!

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: info@em-al.org

Kjo tryezë për GP - Kapitulli 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të **Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility 2021**, i cili zbatohet nga **Lëvizja Europiane në Shqipëri** dhe në bashkëpunim me **Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN)**, **Slovak Foreign Policy Association (SFPA)** dhe **Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)**.





Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryeza për Kapitullin 24: Fuqizimi i Përgjigjes së Shqipërisë ndaj Krimin Kibernetik dhe Mbrojtjes së Fëmijëve në Internet: Përmirësimi i Kuadrit Ligjor dhe i Kapaciteteve Institucionale

15 janar 2026

Xheko Imperial Hotel

09:00 - 11:00

09:00 - 09:30

REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE DHE KAFEJA E MIRËSEARDHJES

09:30 - 09:45

FJALA PËRSHËNDETËSE

Sokol Bizhga, Zëv. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

09:45 - 10:10

SFIDAT E KRIMIT KIBERNETIK NË SHQIPËRI – PRIORITETET KRYESORE NË KUADËR TË KUADRIT LIGJOR DHE NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE

- Gjendja aktuale e kuadrit ligjor për krimin kibernetik dhe përputhja me standardet e BE-së
- Sfida kryesore në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve kibernetike, përfshirë mbrojtjen e fëmijëve online
- Nevojat për ndërtim kapacitetesh të Policisë së Shtetit dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë

Suela Bonjaku, Shefe e Sektorit të Krimeve të Falsifikimit Kompjuterik dhe Aksesit të Paaautorizuar, Njësia e Krimin Kibernetik, Policia e Shtetit

10:10 - 10:30

LUFTA NDAJ KRIMIT KIBERNETIK NË SLLOVAKI – STANDARDET DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA TË BE-SË

- Përafrimi i legjislacionit sllovak me acquis të BE-së (abuzimi seksual i fëmijëve online)
- Masat për parandalimin dhe luftimin e materialeve të abuzimit seksual në internet
- Përvoja praktike në hetimin e krimin kibernetik dhe provat dixhitale
- Forcimi i kapaciteteve policore dhe hetimore (CEPOL, EMPACT) dhe bashkëpunimi ndërkombëtar (Europol, Eurojust, JITS).

Róbert Bohunický, Specialist kundër Falsifikimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Sllovaki

10:30 - 11:00

DISKUTIM NDËRVEPRUES ME AKTORË TË SHOQËRISË CIVILE, PROFESIONISTË TË LIGJIT DHE GRUPE TË TJERA INTERESI

11:00 - 12:00

MBYLLJA E AKTIVITETIT DHE KOKTEJL

Kjo tryezë për GP - Kapitulli 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).

